

# NDIHMJA MJEKËSORE

## kur nuk jetoni në një qendër pritjeje

Nëse, si azilkërkues, nuk jetoni në një qendër pritjeje (noshow), ju mund të kërkonti ndihmë mjekësore. Fedasil do të paguajë për kostot.



### Çfarë është ndihma mjekësore?

- Një vizitë te doktori ose dentisti
- Një kontroll mjekësor me kërkesë të doktorit
- Ilaçe me recetë nga doktori (farmacisti)
- Vizita të tjera mjekësore



### Si të kërkonti nga Fedasil për ndihmë mjekësore?

1. Pak ditë përpara vizitës suaj te doktori, spitali ose farmacisti, ju ose doktori juaj duhet të paraqisni një kërkesë te Njësia e Kostove Mjekësore të Fedasil përmes [formularit në internet](#) (në anglisht, frëngjisht ose holandisht).



### Çfarë informacioni ju duhet që të plotësoni?

- Emri i plotë
- Data e lindjes
- Numri OV ose numri kombëtar (numrat i gjeni në krye të dokumentit të Zyrës së Emigracionit)
- Emri i doktorit/spitalit/farmacisë dhe receta
- Adresa e emailit
- Numri i telefonit
- Data e takimit tuaj

2. Kërkojini dikujt ose një organizatë vullnetare që t'ju ndihmojë nëse nuk kuptoni anglisht, frëngjisht apo holandisht ose nëse nuk keni akses në internet.
3. Fedasil do të shqyrtojë mundësinë mbi pagesën e kostove.
4. Nëse Fedasil pranon të paguajë kostot mjekësore, ju do të merrni me email një dokument të quajtur **requisitorium**.
5. Dokumentin requisitorium do ta merrni me vete kur të shkoni për vizitë te doktori, në spital ose te farmacisti.
6. Pas vizitës suaj, Fedasil do të paguajë për kostot mjekësore.

### Më shumë informacion?

#### Njësia e Kostove Mjekësore të Fedasil

E disponueshme përmes telefonit nga e hëna në të premte ora 9:00 e mëngjesit deri në 12:00 të drekës.

+32 (0)2 213 43 00 (NL)

+32 (0)2 213 43 25 (FR)

Me email: [medic@fedasil.be](mailto:medic@fedasil.be)

#### Informacion për azilkërkuesit në Belgjikë

[www.fedasilinfo.be](http://www.fedasilinfo.be)

[www.asylumbelgium.be](http://www.asylumbelgium.be)